



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në detyrë zyrtare, me datë 15.11.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CERTIFIKATË PËRDORIMIT”
05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 09.10.2023

I. Korrigjohet akti administrativ “Vendim për Certifikatë të Përdorimit” me numër 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 09.10.2023, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër të aplikuesve Drita Neziri, Mehmet, Ibish dhe Gani Çoçaj nga Prishtina dhe investitorit “Trio Construction” sh.p.k me nr. të certifikatës së regjistrimit të biznesit ARBK 810887854, nga Prishtina, për lejinin përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Blloku A, Objekti 1” me etazhitet B+P+8ET e ndërtuar në kuadër të bllokut Urban “C6” të Planit Rregullues “Kalabria” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01852-1, ZK.Prishtinë.

Korrigjimi bëhet në pikën I të dispozitivit dhe te pjesa e arsyetimit, të aktit administrativ të referuar, te pjesa e shënimit të emrit të poseduesve të Lejes së Ndërtimit dhe ate në vend të “Drita Neziri, Mehmet, Ibish dhe Gani Çoçaj” shënohet “Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Sara Çoçaj, Suzan Çoçaj Vjollca Çoçaj, Genc Çoçaj, Gzim Çoçaj, dhe Fllanza Çoçaj”.

II. Me këtë vendim korrigjohet akti administrativ “Vendim për Certifikatë të Përdorimit” me numër 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 09.10.2023 dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Vendim për Certifikatë të Përdorimit” me numër 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 09.10.2023 sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 23.12.2022, i ka pajisur aplikuesit Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Sara Çoçaj, Suzan Çoçaj Vjollca Çoçaj, Genc Çoçaj, Gzim Çoçaj, dhe Fllanza Çoçaj dhe investitorin “Trio Construction” sh.p.k me nr. të certifikatës së regjistrimit të biznesit ARBK 810887854, nga Prishtina, për lejinin përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “Blloku A, Objekti 1” me etazhitet B+P+8ET e ndërtuar në kuadër të bllokut Urban “C6” të Planit Rregullues “Kalabria” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01852-1, ZK. Prishtinë.

Kjo drejtori, në procedurë të arkivimit të kësaj lënde, ka konstatuar se në pikën I të dispozitivit dhe te pjesa e arsyetimit të aktit administrativ të referuar, te pjesa e shënimit të emrit të poseduesve të Lejes së Ndërtimit, është përvjedhur një gabim teknik, ku në vend të emrave të pronarëve “Drita Neziri, Mehmet Çoçaj, Sara Çoçaj, Suzan Çoçaj Vjollca Çoçaj, Genc Çoçaj, Gzim Çoçaj, dhe Fllanza Çoçaj ” janë shënuar gabim emrat e pronarëve “Drita Neziri, Mehmet, Ibish dhe Gani Çoçaj”.

Ky korrigjim bëhet me arsyetimin se bazuar në aktet noteriale me nr. të refencës LRP 2984/2017 dhe nr. të refencës 458/2017 dhe LRP 2691/2017 dhe nr. të refencës 418/2017 është bërë bartja e trashëgimisë të trashëgimtarës-nga Ibish Çoçaj tek trashëgimtarët Suzan dhe Sara Çoçaj përkatësisht nga Gani Çoçaj tek trashëgimtarët Vjollca, Genc, Gzim dhe Fllanza Çoçaj.

Andaj, pas konstatimit të gabimit, në bazë të detyrës zyrtare, i njëjti korrigjohet, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

Ky Vendim u shtyp në 6 (gjashtë) kopje identike fizike dhe i dërgohet: Pronarëve/Investitorit; Drejtorisë së Inspektionit; Drejtorisë së Kadastrit; Drejtorisë së Inspektionit kësaj Drejtorie; në dosje të kësaj lënde; në dosje të lëndës 05 Nr. 391/02-274542/22 dt. 23.12.2022; dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 391/02-02-274542/22 DT. 15.11.2024

Zyrtari:
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi

